



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4923 prot.

Himarë, më 03.07.2026

VENDIM

Nr. 34, datë 30.06.2026

**“PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË KOPSHTIT QENDËR NË KOPSHT ME
ORAR TË PLOTË ME DREKË DHE FJETJE”**

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (i përditësuar), ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për funksionimin e institucioneve të arsimit parashkollor, nga konsultimi publik i bërë me prindërit që aktualisht fëmijët e tyre ndjekin kopshtin dhe çerdhen në kopshtin qendër në varësi të shkollës “Pano Nikolla Meniko” në datë 05.02.2026 ,si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 30.06.2026 pasi shqyrtoi materialin e sjell nga drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë e miratoi me pesëmbëdhjetë (15) vota pro, zero (0) vota kundër, zero (0) vota abstenim dhe si mëposhtë,

VENDOSI :

1. Miratimin e kalimit kopshtit në qendër në varësi të shkollës “Pano Nikolla Meniko”, në funksionim me orar të plotë, duke përfshirë shërbimin ushqimor (drekë) dhe shërbimin e fjetjes, në përputhje me standardet e arsimit parashkollor dhe nevojat e komunitetit.
2. Organizimi i brendshëm i institucionit parashkollor të përshtatet me funksionimin me orar të plotë, duke përfshirë rishikimin e strukturës së personelit (edukatorë, ndihmës edukatorë, personel ndihmës dhe kuzhinë), sipas relacionit dhe analizës financiare bashkëlidhur.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë dhe të ardhurat e institucionit, sipas zërave përkatës të shpenzimeve të miratuara.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë, Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve.

Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

